



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



DRAFT

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE  
PUBLIKE NË KOMUNËN E KAMENICËS**

**Kamenicë, 2024**

Duke u bazuar në nenin 58, shkronja h), e Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 28/04, Qershor 2008) dhe të nenit 70, shkronja h) të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01, Nr. 20203, të datës 21.06.2023, Kryetari i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën\_\_\_\_\_.2024, propozon këtë:

## **RREGULLORE**

### **PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE**

#### **NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAMENICËS**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

##### **Neni 1**

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i zonave të vend-parkimeve, kushteve për shfrytëzimin e vend-parkimeve, mënyrës së pagesës, çmimit dhe llojit të biletave për vend parkim, mënyrës së shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjes për parkimin e veturave në territorin e Komunës së Kamenicës.

##### **Neni 2**

Hapësira publike e parkimit është hapësirë e dedikuar për parkimin e automjeteve, e cila është e rregulluar si vend-parkim dhe është e sinjalizuar me shenja të trafikut dhe me informata rreth zonës së parkimit, me çmimet varësisht nga koha e parkimit, si dhe mënyrën e pagesës së parkimit.

##### **Neni 3**

#### **LLOJET E PARKINGJEVE**

Llojet e parkingjeve në kuptim të kësaj rregullore, konsiderohen:

1. Vend parkimet publike me kohë të caktuar, të cilat përfshijnë:
  - 1.1 Vend parkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vend parkime publike (hapësirat e banesave kolektive dhe institucioneve tjera publike).
  - 1.2 Vend-parkimet "Parko dhe udhëto"
  - 1.3 Vend-parkimet publike - garazhet
2. Parkingjet private.

## Neni 4

1. Vend parkime publike, janë të gjitha vend parkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vend parkime publike, ku pronar është kuvendi komunal dhe menaxhohen nga Komuna apo Ndërmarrja Publike Lokale N.P.L “Dardana” SH.A.

1.1 Hapësirat e vend parkimeve publike, mund t'u jepen në shfrytëzim institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe diplomatike me vendim të veçantë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Ambient dhe Inspektorat.

1.2 Pagesa për shfrytëzimin e vend parkingjeve publike sipas pikës 1 bëhet në Ndërmarrjen Publike Lokale N.P.L “Dardana” SHA, sipas çmimorës së përcaktuar nga Kuvendi Komunal.

2. Vend parkingjet private, janë të gjitha ato vend parkime të cilat i përmbushin kushtet dhe standardet të përcaktuara nga kjo rregullore si:

2.1 Certifikatën e biznesit me kodin për ushtrimin e veprimtarisë,

2.2 Fletën poseduese dhe certifikatën e pronës (origjinali), në emër të pronarit, (nëse prona është me qira, marrëveshjen apo kontratën e noterizuar me pronarin e parcelës për shfrytëzimin e hapësirës së caktuar për vend parkim), jo më e vjetër se gjashtë muaj;

2.3 Projektin për kyçje dhe funksionet e kyçjes së vend parkimit, i hartuar nga Inxhinieri i fushës përkatëse;

2.4 Pëlqimi për kyçje në rrugë;

2.5 Hapësira për vend parkim duhet ti ketë së paku 10 vende për parkim;

2.6 Nuk lejohet kyçja në rrugën e cila ka më tepër se dy shirita për kahe të njëjtë të lëvizjes;

2.7 Parkingu duhet të ketë qasje direkt në rrugë, jo të kaloj për mes trotuarit;

2.8 Të ketë sinjalizimin horizontal dhe vertikal;

2.9 Të jetë e shtruar me kubza betoni ose asfalt;

2.10 Të ketë sistemin digjital të sigurisë, sistemin e kamerave;

2.11 Aktvendimin e pranimit teknik për plotësimin e kushteve minimale teknike.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e pëlqimit për kyçje në rrugë:

3.1 Certifikata e pronës dhe kopja e planit, jo më e vjetër se gjashtë muaj, ose kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e pronës;

4. Lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste të parkingjeve e jep Drejtoria e Shërbimeve Publike Ambient dhe Inspektorat, pas plotësimit të kritereve të parapara sipas nenit 4, të kësaj rregullore.

5. Afati i vlefshmërisë së Lejes së operimit është 3 (tri) vite, nga data e lëshimit të lejes.

6. Revokimi i lejes së operimit, mundë të bëhet në çdo kohë nga organi që e ka lëshuar lejen, kur konstatohet nga inspektori i komunikacionit se subjekti përkatës nuk i është përmbajtur kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

7. Në momentin e pajisjes me leje përkatëse, operatori obligohet të pajiset me arkë fiskale.

8. Kuponi fiskal duhet të lëshohet për secilin shfrytëzues në momentin e fillimit të kohës së parkimit.

9. Taksa për dhënien e lejes si në nenin 4 do të jetë:

9.1 Për marrjen e lejes së përgjithshme të operimit, secili aplikues duhet të paguaj taksën e përgjithshme në vlerë prej **1000,00 €**, dhe

9.2 Taksën vjetore për secilin vend parkim sipas ndarjes së më poshtme:

9.2.1 Zona e I, – **80.00 €** për një vend parkim;

9.2.2 Zona e II, - **40.00 €** për një vend parkim;

9.2.3 Zona e III, - për periudhën dy vjeçare pas pajisjes me leje do të lirohet nga taksa e pagesës, ndërsa pas periudhës dy vjeçare, taksa do të jetë **20.00 €** për një vend parkim; h

9.2.4 Për zonat I, II. dhe III, të cilat nuk punojnë me orar të plotë por vetëm në ditë të caktuara, aplikohet vetëm **50%** e taksës;

10. Vend parkimet publike të cilat menaxhohen nga NPL “Dardana” Sh,A.;

10.1 Vend parkimet publike me pagesë për banorët rezidentë;

10.2 Vend parkimet publike mundë të jenë të përhershme ose të përkohshme rrugore dhe jashtë rrugore;

10.3 Vend parkimet e përhershme publike janë ato vende ku vend parkimi paguhet për tërë vitin kalendarik;

10.4 Vend parkimet e përkohshme publike janë ato vende në të cilat parkimi paguhet gjatë rregullimit të përkohshëm të komunikacionit, gjatë organizimit të manifestimeve të ndryshme, ngjarjeve tjera dhe të ngjashme;

10.5 Vend parkimet rrugore publike, janë parkingjet të cilat gjenden në rrugë dhe trotuare, të shënuara në mënyrë të veçantë me shenja horizontale dhe vertikale të

trafikut, në pajtim me **Ligjin mbi rregullat e trafikut rrugor Nr.05/L-088 dhe udhëzimit administrativ nr.09/2017** për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor dhe me dokumentacion teknik;

10.6 Vend parkimet jashtë rrugore publike mundë të jenë të asfaltuara ose me kubëza betoni.

11. Vend parkimet "Parko dhe udhëto".

11.1 Vend parkimet "Parko dhe udhëto" janë parkimet e lokalizuara në distanca më të mëdha larg qendrës së qytetit, dhe janë të lidhura me një shërbim tërheqës të transportit publik me qendrën kryesore urbane. Sigurimi i hapësirave të parkimit në periferi të qytetit, ka për qëllim ta ndërpresë trafikun e udhëtarëve, të turistëve dhe banorëve dhe t'i transportojë ata në qendër të qytetit për mes lidhjes së shpejtë dhe të shpeshtë, me cilësi të lartë të transportit publik. Kjo do të zvogëlojë nivelin e mbingarkesës në qendër të qytetit dhe do të mundësojë rialokim të hapësirës për qëllime të tjera;

11.2 Lokacioni vend-parkimeve "Parko dhe udhëto", duhet të jetë i pozicionuar mirë, të arrihet lehtësisht dhe të jetë i dukshëm ose i sinjalizuar mirë nga anët e rrugëve kryesore për qasje;

11.3 Kostoja e përdorimit të shërbimit duhet të jetë shumë më e vogël sesa parkimi në parkingjet e zonës qendrore të qëndrimit afatgjatë;

11.4 Lokacioni duhet të ofrojë elemente përcjellëse të mira, si strehim, telefona, siguri, ndërrim dhe dukshmëri të mirë;

11.5 Gjatë shqyrtimit të sistemit "Parko dhe udhëto", ekzistojnë një numër çështjesh specifike, që duhet të adresohen në vlerësimin dhe zhvillimin e skemës për qytetin e Kamenicës, duke përfshirë:

11.5.1 Mundësinë e lokacioneve të ndryshme në pajtim me politikën;

11.5.2 Vend ndodhjen dhe dizajnin e hapësirave;

11.5.3 Klientelen, ofrimin e mënyrave tjera të lëvizjes dhe kapacitetin për biznes;

11.5.4 Lidhshmërinë me vend parkimet në dispozicion në zonën qendrore të qytetit dhe koston e parkimit në zonën qendrore;

11.5.5 Lidhshmërinë me propozimet e tjera brenda qytetit të Kamenicës, duke përfshirë zhvillimin e itinerareve të linjave kryesore dhe dytësore të autobusëve.

## Neni 5

### MENAXHIMI DHE KLASIFIKIMI I VENDPARKIMEVE PUBLIKE

1. Vend parkimet e kaltër, të shënuara me një vijë ngjyrë të kaltër (sinjalizimi vertikal dhe horizontal), është e përcaktuar vetëm për banorët me leje të vlefshme parkimi, të cilët parapaguajnë, dhe mundë të parkohen në ato vend parkime. Të tjerët mund t'i përdorin këto vend parkime, vetëm pasi të kenë paguar përmes aplikacionit online të parkimit ose duke përdorur aparatën e biletave të parkimit. Kjo mënyrë e përdorimit të vend-parkimeve lejon një kohe maksimale të parkimit prej 2 orësh.
2. Vend-parkimet vjollce, të shënuara me një vijë ngjyrë vjollce (sinjalizimi vertikal dhe horizontal), është e përcaktuar vetëm për banorët me leje të vlefshme parkimi të cilët parapaguajnë mund të parkohen në vend parkimet me ngjyrë vjollce. Të tjerët mund t'i përdorin këto vend parkime me se shumti për 24 ore, vetëm pasi të kenë paguar përmes aplikacionit online të parkimit ose duke përdorur aparatën e biletave të parkimit.
3. Vend parkimet e portokallta, të shënuara me një vijë të bardhë të ndërprerë dhe një shenjë trafiku me një shirit ngjyrë portokalli, janë përcaktuar për parkingun me kohë të shkurtër. Të gjithë përdoruesit mund t'i përdorin vend parkimet e portokallta për parkim më së shumti deri në 2 orë dhe vetëm pasi të kenë paguar për mes aplikacionit online të parkimit ose duke përdorur aparatën e biletave të parkimit.
4. Biletat e parkimit mundë të paguhen duke përdorur aparatën e biletave të parkimit (pagesë me anë të kartelës ose parave të gatshme-Euro), ose duke përdorur aplikacionin online të parkimit. Klientët do të identifikohen duke përdorur numrin e targave të automjeteve të tyre. Inspektimi i lejeve të parkimit do të bëhet në mënyrë automatike, duke përdorur një sistem monitorues.

## Neni 6

### ZONAT E PARKINGJEVE

1. Vend parkingjet Publike klasifikohen në zona:
  - 1.1 Zona e I, (qendra e qytetit), dhe klasifikohet si zona me kohëzgjatjen më të shkurtër të lejuar të parkimit. Është hapësira që përfshin qendrën e qytetit;
  - 1.2 Zona e II, Hapësira e cila përfshihet nga përfundimi i zonës së parë deri te rruga qarkore;
  - 1.3 Zona e III, periferike.

## SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL

### Neni 7

1. Parkingjet janë sipërfaqe për parkimin e automjeteve, të cilat përbehen nga një apo më shumë vende të parkimit. Vendi për parkim është vendi i përcaktuar për parkimin e automjeteve. Mund të jetë i vendosur në parkingje të rregulluara, në rrugë apo në garazhe. Detyra e vend parkimit të shënuar është vendosja e automjeteve në hapësirë, në njërën nga mënyrat e organizimit të parkimit me dimensionet përkatëse:

1.1. Vend parkimi në këndin  $90^\circ$ - me dimensione 250(cm) X 455(cm), gjerësia e kalimit 550 (cm), për lëvizje një ose dy kahore;

1.2. Vend parkimi në këndin  $60^\circ$  - me dimensione 250 (cm) X 485 (cm), gjerësia e kalimit 470 (cm) për lëvizje një kahore dhe 550 (cm) për lëvizje dy kahore;

1.3. Vend parkimi në këndin  $45^\circ$  - me dimensione 250 (cm) X 485 (cm), gjerësia e kalimit 350 (cm) për lëvizje një kahore dhe 550 (cm) për lëvizje dy kahore;

1.4. Vend parkimi në këndin  $30^\circ$ - me dimensione 250 (cm) X 425 (cm) gjerësia e kalimit 350 (cm) për lëvizje një kahore dhe 550 (cm) për lëvizje dy kahore;

1.5. Vend parkimi në këndin  $0^\circ$ - me dimensione 215 (cm) X 640 (cm), gjerësia e kalimit 350 (cm) për lëvizje një kahore dhe 550 (cm) për lëvizje dy kahore;

1.6. Vend parkimi i rrethuar - 270 (cm) X 550 (cm);

1.7. Vendet për parkim shënohen me vija horizontale me gjerësi të vijës prej 10 (cm). Vendet e veçanta të parkimit (për persona me aftësi të kufizuara, vende të rezervuara etj.) shënohen me ngjyre të kaltër.

2. Vendosja e sinjalizimit përkatës, vertikal dhe horizontal të vend parkimeve publike bëhet nga Komuna, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, ndërsa të parkingjet private sinjalizimi horizontal dhe vertikal kryhet nga vetë pronari në kuadër të projektit nën mbikëqyrjen e organit kompetent.

## **MËNYRA E PAGESËS**

### **Neni 8**

Mënyra e pagesës së parkimit të menaxhuar nga NPL “Dardana” Sh.A. do të përcaktohet nga ana e kësaj ndërmarrje për mes një akti të sajë të brendshëm.

### **Neni 9**

#### **BILETAT E RREGULLTA TË PARKIMIT – ORËSHE DHE DITORE**

Propozimin e çmimit për shfrytëzim të vend parkimit si dhe kohëzgjatjen e atij shfrytëzimi duhet përmbledhur për periudhën kohore gjatë ditës, për këtë arsye propozohet periudha kohore në të cilën është vendosur regjimi i propozuar i shfrytëzimit gjatë ditës. Prandaj për 2 orët e para do të paguhet çmimi i biletës orëshe, ndërsa vazhdimi i parkimit do të ishte karakterizuar si parkim gjatë gjithë ditës dhe në këtë rast do të shitej bileta ditore e parkimit.

### **Neni 10**

#### **BILETAT MUJORE DHE VJETORE TË PARKIMIT**

1. Banoreve rezident do të ju ofrohet mundësia e parkimit të privilegjuar në kapacitetet publike të parkimit, (d.m.th. në ato lokacione në të cilat është i paraparë parkimi i privilegjuar) me pagese minimale.
2. Për këtë qëllim duhet të kryhet procedura e nevojshme administrative (dëshmia e adresës së banimit) dhe të paguhen tarifatat administrative dhe shpenzimet materiale të lëshimit të biletës së parkimit të privilegjuar, për një periudhë të caktuar nga një apo më shumë muaj, derisa vetë ta ndërpresë atë.
3. Shfrytëzimi i privilegjuari i vend parkimeve u referohet tri kategorive të shfrytëzuesve dhe me prioritet, sipas renditjes në vijim:
  - 3.1 Banorët të cilët jetojnë në rrugën ku parkimi paguhet (rezident);
  - 3.2 Personat juridikë të cilët e kanë selinë e vetë në rrugë ku parkimi paguhet, vetëm për veturat e tyre zyrtare;
  - 3.3 Të punësuarit të cilët punojnë në zonën ku parkimi paguhet, varësisht nga gjendja ekzistuese në vend parking.

### **Neni 11**

#### **PARKINGJET E REZERVUARA**

Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë të rezervojnë hapësirat për parkim në vend parkingjet publike të cilat gjenden nën menaxhim të NPL “Dardana” Sh.A. me pagesë të çmimit të përcaktuar sipas çmimorës së miratuar nga Kuvendi Komunal. Çmimi i propozuar duhet të jetë në harmoni me rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba komunale.



## Neni 12

### MËNYRA E PAGESËS SË ÇMIMIT PËR PARKIM

1. Për shfrytëzimin e parkingut, shfrytëzuesi është i obliguar të paguaje çmimin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vend parkimit dhe zonës në të cilën gjendet Vend parkimi;
2. Çmimi propozohet nga Komuna dhe miratohet nga Kuvendi i Komunës;
3. Shfrytëzuesi është i obliguar të paguaj çmimin e parkimit për çdo orë të filluar të shfrytëzimit;
4. Shfrytëzuesi është i obliguar të respektojë kohën e lejuar për parkim.

## Neni 13

### SHFRYTEZIMI I PARKINGJEVE

1. Përdoruesi i parkingut brenda kuptimit të dispozitave të kësaj rregullore konsiderohet ngasësi ose pronari i një automjeti, nëse vozitësi i cili ka parkuar automjetin në parking nuk identifikohet.
2. Pagesa e parkimit në zonën I bëhet çdo ditë të javës, duke filluar nga ora 7:00 deri në ora 24:00h.
3. Pagesa e parkimit në zonën II bëhet çdo ditë, në intervalin kohor prej orës 07:00 deri në orën 20:00. Pagesa nuk bëhet të dielave dhe ditëve të festave publike.
4. Përdoruesi i parkingut është i obliguar që:
  - 4.1 Të përdorë vendin e parkimit në përputhje me sinjalizimin e trafikut vertikal dhe horizontal, me të cilin është i shënuar vendi i parkimit;
  - 4.2 Të veprojë në përputhje me kufizimin e kohës së shfrytëzimit të hapësirave të parkimit të përcaktuara sipas kësaj rregullore;
  - 4.3 Të paguaj përdorimin e hapësirave të parkimit sipas kohës së mbajtjes, në mënyrën e përcaktuar dhe sipas listës së çmimeve të vlefshme pas kohës së fillimit;
  - 4.4 deri në skadimin e kohës së parkimit të paguar dhe në përputhje me këtë rregullore ta largojë automjetin nga parkingu.

## Neni 14

### KATEGORITË E LIRUARA NGA OBLIGIMI I PAGESËS PËR PARKIM

1. Nga obligimi për pagimin e shfrytëzimit të vend parkingjeve, lirohen kategoritë si në vijim:
  - 1.1 Automjetet zyrtare të Komunës dhe të nivelit qendror,
  - 1.2 Automjetet me tabela diplomatike,

- 1.3 Automjetet zyrtare të FSK dhe policisë së Kosovës,
- 1.4 Personat me nevoja të veçanta të cilët janë nën përcjellje të personit shoqërues.

## **Neni 15**

### **NDALESAT E PARKIMIT**

1. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve në kundërshtim me shenjat e trafikut, sinjalizimin horizontal dhe vertikal;
2. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve të paregjistruara;
3. Lënia e një automjeti që nuk funksionon, të braktisur ose të dëmtuar;
4. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve në hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe në vende të rezervuara parkimi, nëse përdoruesi nuk i përket kategorive të përmendura;
5. Parkimi i një automjeti që nuk i përket kategorisë së automjetit për të cilin është planifikuar parkimi;
6. Parkimi i automjetit për kohë më të gjatë se koha e parashikuar për parkim në zonën e dhënë;
7. Nxënia e parkingjeve duke vendosur rrethoja ose pengesa të ngjashme;

## **Neni 16**

### **SHKELJET BRËNDA PARKINGJEVE TË MENAXHUARA NGA NPL "Dardana" Sh.A.**

1. Në rast të mos kryerjes së pagesës për parkim, zyrtari (kontrollori) i NPL "Ambienti obligohet të pres 5 minuta nga momenti i parkimit të automjetit, dhe nëse pas kalimit të këtij afati kohor qytetari nuk kryen pagesën, automjeti do të bllokohet për mes vendosjes së bllokadës.
2. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse shfrytëzuesi nuk ndodhet në vend ngjarje ose kundërshton largimin e automjetit, zyrtari përkatës në bashkëpunim me zyrtarët policor, do të urdhëroj largimin e automjetit brenda afatit të caktuar apo vendosin për lejimin e konfiskimit duke lajmëruar automjetin special (merimanga);
3. Në raste se pagesa për zhblokim të automjetit nuk kryhet brenda një ore, automjeti do të bartet në autoparkun e komunës, ku për bartjen e automjetit qytetari obligohet të paguaj çmimin e përcaktuar sipas vendimit mbi caktimin e shumës maksimale të shpenzimeve të zhvendosjes së mjeteve me nr. 01/0313 të datës 25.03.2022 (të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme). Nëse personi të cilit i është bllokuar automjeti, paraqitet në vend parkimin e automjetit gjatë përgatitjes për bartje, obligohet të paguaj vetëm gjysmën e çmimit për bartje të automjetit sipas çmimorës së përcaktuar.
4. Në rast se automjeti është parkuar në kundërshtim me këtë rregullore dhe bllokohet/pengon mbarëvajtjen e trafikut rrugor zyrtarët e NPL "Dardana" në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe OE (kompaninë e kontraktuar) nga AK, janë të autorizuar të

- bëjnë bartjen e menjëhershme të automjetit.
5. Për zhbllokimin e automjetit, qytetarët duhet të paguajnë shumën prej **15 €** (pesëmbëdhjete euro) për OE, si dhe 15€ (pesëmbëdhjete euro) për Komunën e Kamenicës nga çmimi total prej 30 € (tridhjetë euro).
  6. Zyrtarët/kontrollorët e NPL e NPL “Dardana” Sh.A. në bashkëpunim me zyrtarët e policisë së Kosovës të autorizuar të ushtrojnë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj personave të cilët veprojnë në kundërshtim me urdhërat e zyrtarëve/kontrollorëve të ndërmarrjes dhe të ndërmarrin masat e duhura për shfrytëzimin e parkingjeve publike dhe private, në harmoni me dispozitat e kësaj rregullore.
  7. Qytetarët mundë ti shfrytëzojnë hapësirat publike të destinuara si vend parkingje publike për gjatë rrugëve publike/parkingjeve komerciale, për 5 (pesë) minuta pa pagesë.
  8. Për bllokimin, zhbllokimin dhe bartjen apo zhvendosjen e mjeteve vlenë vendimi mbi caktimin e shumës maksimale të shpenzimeve të zhvendosjes së mjeteve me nr. 01/0313 të datës 25.03.2022 9 (të lëshuar nga MPB). Vendi (autoparku) për vendosjen e mjeteve është i definuar dhe menaxhohet nga Komuna.

## **Neni 17**

### **MBIKËQYRJA**

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregullore e kryen Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit e cila është e obliguar dhe kompetente të mbikëqyrë:
  - 1.1 Lejen e operimit të secilit parking publik apo privat;
  - 1.2 Përbushjen ose jo të kriterëve të përcaktuara këtë rregullore lidhur me parkingjet private si dhe dispozitat tjera që ndërlidhen me kriteret për operimin e parkingjeve publike;
  - 1.3 Rregullsitë e përgjithshme teknike të parkingjeve publike dhe private;
  - 1.4 Kontrollimin e procedurave të ndjekura nga zyrtarët e NPL “Dardana” Sh.A.
  - 1.5 Kontrollimin e implementimit të çmimorës së miratuar në Kuvendin Komunal;
  - 1.6 Kontrollimin nëse parkingjet publike dhe private operojnë në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore;
  - 1.7 Të urdhëroj NPL , subjektin privat për mënjanimin e mangësive të evidentuara gjatë inspektimit brenda një afati të caktuar.

### **PROCEDURAT SIPAS ANKESAVE**

## **Neni 18**

1. Të gjithë qytetarët kanë të drejtë që në çdo kohë të ushtrojnë ankesë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, vetëm për çështjet të cilat ndërlidhen dhe kanë të bëjnë me autorizimet e kësaj drejtorie si që është përcaktuar në nenin 17 të kësaj rregullore.
2. Në rast të ushtrimit të ankesës nga qytetarët pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Ambientit dhe Inspektoratit, si që është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kompetent për vendosjen e çështjes do të jetë Inspektori i Komunikacionit nga kjo

drejtori.

3. Të gjitha ankesat e tjera që nuk janë pjesë e autorizimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Ambientit dhe Inspektoratit, sipas nenit 17 të kësaj rregullore, palët duhet ti drejtohen NPL “Dardana” Sh.A.

## **DISPOZITAT NDESHKUESE**

### **Neni 19**

1. Për shkelje të parapara në nenin 15, paragrafi 1 dhe 5, dënohen me gjobë prej 30€;
2. Për shkelje të parapara në nenin 15, paragrafi 2, 3 dhe 7, dënohen me gjobë prej 100€;
3. Për shkelje të parapara në nenin 15, paragrafi 4 dhe 6, dënohen me gjobë prej 20€;
4. Nëse personi juridik operon pa leje për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, dënohet me gjobe prej 1000-3000€;
5. Operatori publik ose privat i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore, dënohet me gjobë prej 200€;
6. Operatorit publik ose privat, i ndalohet që të kryej shërbime të riparimit, apo aktiviteteve të tjera që ndikojnë në funksionimin normal të parkimit, dënohet me gjobe prej 800 - 1 000 €.
7. Për çdo shkelje nga operatori publik apo privat që është në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregullore, dënohet me gjobe prej 100-500€, me përjashtim te pikave nga 1- 6.
8. Nëse operatori publik apo privat përsërit shkeljet e përshkruara më lartë deri në tri herë e më tepër, i revokohet leja.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 20**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë se Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web-faqen e Komunës.

Kamenicë,

Datë: xxxxxxxxxxx

**Kryesuesi i K. Komunal**

---

**Liridon Kastrati**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës  
Opština Kamenica  
Kamenica Municipality



NACRT

**PRAVILNIK O ORGANIZOVANJU I KORIŠĆENJU JAVNIH PARKINGA U OPŠTINI  
KAMENICA**

**Kamenica, 2024**

Na osnovu člana 58, slovo h), Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040, (Službeni list Republike Kosova, Br. 28/04, Juni 2008) i člana 70, slovo h) Statuta Opštine Kamenica Š 01, Br.20203, od/datum 21.06.2023, Predsednik Opštine Kamenica, na sednici Skupštine Opštine održanoj dana \_\_\_\_\_2024, predlaže ovaj:

## **PRAVILNIK**

# **O ORGANIZOVANJU I KORIŠĆENJU JAVNIH PARKINGA NA TERITORIJI OPŠTINE KAMENICA**

## **OPŠTE DOREDBE**

### **Član 1**

Svrha ovog Pravilnika je određivanje parking prostora, uslova za korišćenje parking prostora, način preplate, cena i vrsta karata za parking plac, način korišćenja i nadzor za parkiranje vozila na teritoriji Opštine Kamenica.

### **Član 2**

Javni parking prostor je prostor namenjen za parkiranje vozila, uređen je kao parking mesto i signalizirano saobraćajnim znacima i informacijama za parking mesto kao i način za plaćanje parkinga.

### **Član 3**

## **VRSTE PARKINGA**

Vrste parkinga u smislu ovog pravilnika, smatraju se:

1. Javni parking prostori sa određenim vremenom koji uključuju:
  - 1.1 Parking prostor duž javnih saobraćajnica, prostora namenjeno kao mesto javnog parkinga (prostor kolektivnog stanovanja i drugih javnih institucija).
  - 1.2 Parking mesta "Parkiraj i vozi"
  - 1.3 Javna parking mesta - garaže
2. Privatni parking.

### **Član 4**

1. Javni parking mesta su sva ona mesta parkiranja duž javnih saobraćajnica i prostor namenjen kao javni parking prostor, a vlasnik je skupština opštine i njima upravlja Opština ili Lokalno Javno Preduzeće LJP “Dardana” AD.

1.1 Javni parking prostor, ustupa se na korišćenje domaćim, međunarodnim i diplomatskim institucijama uz posebnu odluku Odeljenja Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije.

1.2 Plaćanje za korišćenje javnih parkinga prema tački 1 se vrši kod Lokalnog Javnog Preduzeća LJP “Dardana” AD, po cenovniku koji odredila Skupština Opštine.

2. Javni parking prostori su svi oni prostori parkiranja koji ispunjavaju uslove i standarde utvrđene ovim pravilnikom kao:

2.1 Sertifikat o poslovanju sa šifrom za obavljanje delatnosti,

2.2 Posedovni list i imovinsko uverenje (original), na ime vlasnika, (ako je imovina iznajmljena sporazum ili ugovor noterizovan sa vlasnikom parcele za korišćenje određenog prostora za mesto parkiranja, ne starije od šest meseci);

2.3 Projekat za uključenje i funkcije uključanja u parking mesta, izrađen od Inženjera dotične oblasti;

2.4 Saglasnost za uključenje na put;

2.5 Prostor za mesto parkiranja da poseduje najmanje 10 mesta za parkiranje.

2.6 Nije dozvoljeno uključenje na put koji ima više od dve staze za isti pravac kretanja;

2.7 Parking mora imati direktan pristup ulici, ne da prođe preko trotar;

2.8 Da ima horizontalnu i vertikalnu signalizaciju;

2.9 Da je popločano betonskim pločama i asfaltom;

2.10 Da ima digitalni sigurnosni sistem, sistem kamera;

2.11 Rešenje za tehnički prijem za ispunjavanje minimalnih tehničkih uslova.

3. Dokumentacija potrebna za dobijanje saglasnosti za uključenje na put;

3.1 Imovinsko uverenje i kopija plana, ne starije od šest meseci, ili noterizovan ugovor za korišćenje imovine;

4. Dozvolu za obavljanje poslovne delatnosti parkinga izdaje Odeljenje Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije, nakon ispunjavanja predviđenih kriterijuma, prema članu 4 ovog pravilnika.

5. Rok važenja Dozvole za rad je 3 (tri) godine, od dana izdavanja dozvole.

6. Poništenje upotrebne dozvole može se izvršiti u svako vreme od organa koji izdao dozvolu, kada to konstatuje saobraćajni inspektor da dotični subjekat

nije se pridržavao utvrđenih kriterijuma iz ovog pravilnika.

7. U trenutku opremanja odgovarajućom dozvolom operater dužan je se opreмати fiskalnom kasom.

8. Fiskalni kupon treba izdati svakom korisniku od početka vremena parkiranja.

9. Taksa za izdavanje dozvole kao u članu 4 biće:

9.1 Za dobijanje opšte dozvole za rad, svaki podnosilac zahteva treba da plati opštu taksu vrednosti od 1000,00 €, i

9.2 Godišnju taksu za svako parking mesto kao u dolenaavedenoj podeli:

9.2.1 Zona I, – 80.00 € za jedno parking mesto

9.2.2 Zona II, - 40.00 € za jedno parking mesto

9.2.3 Zona III, - za dvogodišnji period nakon opremanja dozvolom oslobodiće se plaćanja takse, dok nakon dovogodišnjeg perioda taksa biće 20.00 € za jedno mesto parkiranja;

9.2.4 Za zone I, II. i III, koje ne rade punim radnim vremenom nego samo u određenim danima, primenjuje se samo 50% od takse;

10. Mesta javnog parkinga kojima upravlja LJP “Dardana” AD.;

10.1 Mesta javnog parkinga plaćanjem za stalne stanovnike;

10.2 Mesta javnog parkinga mogu biti stalni i privremeni putni i van putni;

10.3 Mesta stalnog javnog parkinga su mesta gde se mesto parkiranja plaća za kalendarsku godinu;

10.4 Privremena javna parking mesta su ona mesta koji se parking plaća za privremeno regulisanje saobraćaja, tokom organizacije raznih manifestacija, drugih i sličnih događaja;

10.5 Mesta parkiranja na javnom putu, imaju parking mesta koja se nalaze na putu trotoaru, obeleženo na poseban način horizontalnim i vertikalnim saobraćajnim znacima u smislu Zakona o saobraćajnim propisima Br.05/L-088 i administrativnog uputstva br.09/2017 za signalizaciju i saobraćajnim drumskim propisima i tehničke dokumentacije;

10.6 Mesta parkiranja van javnih puteva, mogu biti asfaltirana ili betonskim pločicama.



## 11. Parking mesta "Parkiraj i vozi".

11.1 Parking mesta "Parkiraj i vozi" lokalizovani parkinzi u većoj udaljenosti od centra grada, i povezana su jednom vučnosm službom javnog transporta sa glavnim urbanim centrom. Obezbeđivanje prostora za parkiranje u periferiji grada za cilj ima da obustavlja saobraćaj putnika, turista i transportuje u centar grada kroz brzu liniju i bržu liniju visokog kvaliteta javnog transporta. Time umanjuje stepen gužve u centru grada te da će omogućiti preraspodelu površine u druge svrhe;

11.2 Lokacija mesto parkiranja "Parkiraj i vozi" , mora da je dobro pozicionirana, da je lakše dostupan i vidljiv ili dobro signaliziran sa strane glavnih puteva za pristup;

11.3 Troškovi korišćenja usluge moraju biti mnogo manji od parkinga u parkingu centralne zone dugoročnog boravka;

11.4 Lokacija treba da pruža dobre prateće elemente, zaklon, telefon, bezbednost, zamenu i dobru vidljivost;

11.5 Tokom pregleda sistema "Parkiraj i vozi", postoji znatan broj specifičnih stvari, koje treba adresovati u proceni u razvoju šeme za grad Kamenica, uključujući:

11.5.1 Mogućnost raznih lokacija usklađeno sa politikama;

11.5.2 Lokacija i dizajn prostora;

11.5.3 Klijentelu, pružanje drugog načina kretanja i kapacitet za poslovanje/biznis;

11.5.4 Mogućnost povezivanja lokalnog parkinga sa centralnom gradskom zonom i troškovi parkiranja u centralnoj zoni;

11.5.5 Povezanost sa drugim predlozima unutar grada Kamenica, uključujući razvoj glavnih i sporednih autobuskih linija.

## Član 5

### UPRAVLJANJE I KLASIFIKACIJA JAVNIH PARKING MESTA

1. Javni plavi parking, obeležen plavom linijom (vertikalna i horizontalna signalizacija) je definisana samo za stanovnike sa važećom dozvolom parkiranja, koji preplaćuju i mogu se parkirati na tim parking mestima. Ostali mogu da koriste ova parking mesta samo onda kada plaćaju parkiranja kroz online prijavu ili primenjujući aparat kartice za parkiranje. Ovaj način primene mesta parkiranja dozvoljava maksimalno vreme parkiranja od 2 časova.
2. Ljubičasto parkiranje, obeleženo ljubičastom bojom (vertikalna i horizontalna

signalizacija) je definisana samo za stanovnike sa važećom dozvolom parkiranja, koji preplaćuju i mogu se parkirati na tim parking mestima ljubičaste boje. Ostali mogu da koriste ova parking mesta najviše 24 časova, mogu da koriste ova parking mesta samo kada plaćaju kroz online prijavu parkiranja ili primenjujući aparat kartica za parkiranje.

3. Narandžasto parkiranje, obeleženo belom prekinutom linijom i saobraćajni znak trakom narandžaste boje, definisani su za parking kraćeg vremena. Svi korisnici mogu da koriste narandžasti parking najviše do **2 časova** samo kada plaćaju kroz **online** prijavu parkiranja ili primenjujući aparat kartica za parkiranje.
4. Kartice parkiranja mogu se uplatiti primenjujući aparat kartica za parkiranje (plaćanje karticom ili gotovim novcem – Evro), ili korišćenjem onlajn aplikacije za parkiranje. Klijenti mogu se identifikovati primenjujući broj registarskih tablica njihovih vozila. Inspekcija dozvola za parkiranje će se obaviti automatski korišćenjem sistema za praćenje.

## **Član 6**

### **ZONE ZA PARKING**

1. Javni parkinzi se po zonama klasifikuju:
  - 1.1 Zona I, (centar grada) klasifikuje se zona sa najkraćim trajanjem vremena za dozvolu parkiranja. To je prostor koji obuhvata centar grada;
  - 1.2 Zona II, Prostor koji obuhvata od završetka prve zone do kružni put;
  - 1.3 Zona III, prigradsko.

### **HORIZONTALNA I VERTIKALNA SIGNALIZACIJA**

## **Član 7**

1. Parkirališta su prostori za parkiranje vozila, koji se sastaje od jedno ili više parking mesta. Mesto za parkiranje je određeno mesto za parkiranje vozila. Može biti postavljeno na uređenim parkiralištima, na ulici ili u garaži. Dužnost obeleženog mesta parkiranja je postavljanje vozila u prostoru na jednom od načina organizovanja parkiranja sa odgovarajućim dimenzijama:
  - 1.1. Parking mesto pod uglom 90°- dimenzijama 250 (cm) X 455(cm), širina prolaza 550 (cm), za jednosmerno ili dvosmerno kretanje.
  - 1.2. Parking mesto pod uglom 60 ° - dimenzijama 250 (cm) X 485 (cm), širina

- prolaza 470 (cm) za jednosmerno kretanje i 550 (cm) za dvosmerno kretanje;
- 1.3. Parking mesto pod uglom 45° - dimenzijama 250 (cm) X 485 (cm), širina prolaza 350 (cm) za jednosmerno kretanje i 550 (cm) dvosmerno kretanje;
- 1.4. Parking mesto pod uglom 30°- dimenzijama 250 (cm) X 425 (cm) širina prolaza 350 (cm) za jednosmerno kretanje i 550 (cm) dvosmerno kretanje;
- 1.5. Parking mesto pod uglom 0°- dimenzijama 215 (cm) X 640 (cm), širina prolaza 350 (cm) za jednosmerno kretanje i 550 (cm) za dvosmerno kretanje;
- 1.6. Ograđeno parking mesto - 270 (cm) X 550 (cm);
- 1.7. Mesta za parking su obeležena horizontalnim linijama širinom linije od 100 (cm). Posebni parking prostori (za osobe sa ograničenim sposobnostima, rezervisana mesta itd.) obeležena plavom bojom.
2. Postavljanje odgovarajuće vertikalne i horizontalne signalizacije kod javnih parking mesta vrši Opština, odnosno Odeljenje Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije, dok kod privatnih parkinga horizontalna i vertikalna signalizacija se vrši od samog vlasnika u okviru projekta pod nadzorom nadležnog organa.

## **NAČIN PLAĆANJA**

### **Član 8**

Upravljeni način plaćanja parkiranja od LJP "Dardana" AD će se utvrđivati od strane ovog preduzeća kroz njen interni akt.

### **Član 9**

#### **REDOVNE SATNE I DNEVNE KARTE PARKINGA**

Predlog cene za korišćenje parking mesta kao i njegovo trajanje korišćenja treba sabirati za vremenski period u toku dana, zato se predlaže vremenski period u koji je postavljen predloženi režim korišćenja tokom dana. Stoga za prvih 2 sata plaća se cena satne karte, dok produžetak parkinga bilo bi okarakterisano kao parking tokom dana i u tom slučaju prodavala bi se dnevna karta parkinga.

### **Član 10**

#### **MESEČNE I GODIŠNJE PARKING KARTE**

1. Stalnim stanovnicima puža se mogućnost privilegovanog parkinga u javnim parking kapacitetima, (znači u onim lokacijama u kojima je predviđen privilegovani parking) minimalnim plaćanjem.
2. U tu svrhu mora se sprovesti neophodna administrativna procedura (dokaz adrese stanovanja) i da se uplaćuju administrativne tarife i materijalni troškovi izdavanja karte privilegovanog parkinga za određen period od mesec ili više meseci, dok sam ne prekine.
3. Privilegovano korišćenje parking mesta se referiše trima kategorijama korisnika i po prioritetu, prema sledećem redosledu:
  - 3.1 Stanovnici koji žive u ulici gde se parking plaća (stalni);
  - 3.2 Pravna lica koji svoje sedište imaju u ulici gde se parking plaća, samo za njihova službena vozila;
  - 3.3 Zaposleni koji rade u zoni gde se parking plaća, zavisno od postojećeg stanja na parkingu.

## **Član 11**

### **REZERVISAN PARKING**

Fizička i pravna lica imaju pravo da rezervišu prostor za parking na javnim parking mestima koji su pod upravom LJP "Dardana" AD uz plaćanje cene utvrđeno po cenovniku koji odobrila Skupština Opštine. Cena koja je predložena treba da je usaglašena sa opštinskim pravilnikom za takse, tarife i opštinske kazne.

## **Član 12**

### **NAČIN PLAĆANJA CENE ZA PARKING**

1. Za korišćenje parkinga, korisnik je dužan da plati cenu parkinga, zavisno od vreme korišćenja parking mesta i zone u kojoj se nalazi.  
Parking mesto,
2. Cenu predlaže Opština i odobrava Skupština Opštine;
3. Korisnik je dužan da plati cenu parkinga za svaki započeti sat korišćenja;
4. Korisnik je dužan da ispoštuje vreme dozvoljeno za parking.

## **Član 13**

### **KORIŠĆENJE PARKINGA**

1. Korisnikom parkinga u smislu odredaba ovog pravilnika smatra se upravljač ili vlasnik vozila, ako vozač koji je parkirao vozilo na parking nije identifikovan.
2. Plaćanje parkinga u zoni I se vrši svakog dana u nedelji počev od 7:00 do 24:00h.
3. Plaćanje parkinga u zoni II se svakog dana u vremenskom intervalu od 07:00 do

20:00. Plaćanje se ne vrši nedeljom i državnim praznicima.

4. Korisnik parkinga dužan je da:

4.1 Koristiti parking mesto u skladu sa saobraćajnom signalizacijom vertikalnim i horizontalnim kojim je obeleženo parking mesto;

4.2 da postupi u skladu sa ograničenjem vremena korišćenja parking mesta utvrđeno prema ovom pravilniku;

4.3 da plati korišćenje parking mesta prema vremenu održavanja, kako je utvrđeno prema važećem cenovniku od početnog vremena;

4.4 do isteka vremena plaćenog parkinga i u skladu sa ovim pravilnikom da ukloni vozilo sa parkinga.

## **Član 14**

### **OSLOBODENE KATEGORIJE OD OBAVEZE PLAĆANJA PARKINGA**

1. Od obaveze za plaćanje korišćenja parking mesta, oslobodaju se sledeće kategorije:

1.1 Službena vozila Opštine i centralnog nivoa,

1.2 Vozila sa diplomatskim registarskim tablicama,

1.3 Službena vozila KBS i policije Kosova,

1.4 Lica sa posebnim potrebama koji su pod pratnjom lica u pratnji.

## **Član 15**

### **ZABRANJENO PARKIRANJE**

1. Parkiranje i zaustavljanje vozila u suprotnosti sa saobraćajnim znacima, horizontalnom i vertikalnom signalizacijom

2. Parkiranje i zaustavljanje neregistrovanih vozila:

3. Stavljanje vozila koje nije u funkciji, napušteno ili oštećeno;

4. Parkiranje i zaustavljanje vozila na parking mestima za lica sa ograničenim sposobnostima, kao i na rezervisanim parking mestima, ako korisnik ne pripada navedenim kategorijama;

5. Parkiranje vozila koje ne pripada kategoriji vozila za koji je planirano parkiranje;

6. Parkiranje vozila za duže vreme nego predviđeno vreme za parkiranje u datoj zoni;

7. Zauzimanje parkinga ograđivanjem ili postavljanjem sličnih prepreka

## **Član 16**

### **PREKRŠAJI UNUTAR PARKIRALIŠTA KOJIMA UPRAVLJA LJP "Dardana" AD**

1. U slučaju neplaćanja parkinga, službenik (kontrolor) LJP-a dužan je sačekati 5 minuta od trenutka parkiranja vozila i ako nakon isteka vremenskog roka, građanin ne plaća preplatu, vozilo se blokira putem postavljanja blokade.
2. U slučaju stava 1 ovog člana, ako korisnik nije na mestu događaja ili se protivi uklanjanja vozila, dotični službenik u saradnji sa policijskim službenicima, narediće uklanjanje vozila u okviru zakonskog roka utvrđeno ili odlučuje za dozvoljavanje oduzimanje tako što će obavestiti specijalno vozilo (pauk);
3. U slučajevima kada se plaćanje za deblokiranje vozila ne izvrši u roku od jedan sat , vozilo će biti premešteno do parkinga vozila, gde za premešteno vozilo građanin je dužan da plati utvrđenu cenu po odluci za određivanje maksimalnog iznosa troškova premeštanja vozila, br. 01/0313 od/datum 25.03.2022 (izdato od Ministarstvo Unutrašnjih Poslova). Ako lice kome je blokirano vozilo, se pojavljuje na parking mesto vozila tokom pripreme za prevoz, dužan je da plati samo polovinu cene za prevoz vozila prema utvrđenom cenovniku.
4. U slučaju da je vozilo parkirano suprotno ovom pravilniku i blokira/ometa nesmetan rad službenika u drumskom saobraćaju LJP “Dardana” u saradnji sa policijom Kosova i OE (ugovorenom kompanijom) od AK, ovlašćeni su da izvrše neposredan prenos vozila.
5. Za deblokiranje vozila, građani treba da plate iznos od 15 € (petnaest evra) za EO, kao i 15€ (petnaest evra) za Opštinu Kamenica od ukupne cene od 30 € (trideset evra).
6. Službenici/kontrolori LJP “Dardana” AD u saradnji sa policijskim službenicima Kosova ovlašćeni su da podensu zahtev za početak prekršajnog postupka nad licima koji postupaju suprotno naredaba službenih lica/kontrolora preduzeća i da će preduzeti neophodne mere za korišćenje javnih i privatnih parkinga u skladu sa odredbama ovog pravilnika.
7. Građani mogu da koriste javne prostore namenjene kao parking mesta duž javnih puteva/komercijalnih parkinga, za 5 (pet) minuta besplatno.
8. Za blokiranje, deblokiranje, prevoz ili dislokaciju vozila važi odluka za određivanje maksimalnog iznosa troškova za dislokaciju vozila br. 01/0313 od/datum 25.03.2022 izdalo (MUP-a). Mesto (vozni park) za parkiranje vozila je definisano i upravlja se od strane Opštine.

## **Član 17**

### **NADZOR**

1. Nadzor sprovođenja ovog pravilnika vrši Odeljenje Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije, koje je dužno i nadležno za nadzor:
  - 1.1 Dozvola za rad svakog javnog ili privatnog parkirališta
  - 1.2 Ispunjenost ili ne kriterijuma definisani ovim pravilnikom u vezi privatnih parkinga kao i drugih odredaba vezano kriterijuma za rad javnih parkinga;
  - 1.3 Opšti tehnički propisi javnih i privatnih parkirališta;
  - 1.4 Provera procedura koje poštuju službenici LJP “Dardana” AD.
  - 1.5 Provera sprovođenja odobrenog cenovnika u Skupštini Opštine;
  - 1.6 Provera ukoliko javna i privatna parkirališta rade u skladu sa odredbama ovog pravilnika;

1.7 Da LJP naredi privatnom subjektu evidentovano za vreme inspekcije u okviru određenog roka, otklanjanje slabosti.

## **ŽALBENI POSTUPCI**

### **Član 18**

1. Svi građani imaju pravo da u svako vreme prijave žalbu kod Odeljenja Javnih Usluga, Sredine i Inepskecije, samo u vezi pitanja vezano i koja se odnose ovlašćenja ovog odeljenja kako je članom 17 ovog pravilnika utvrđeno.
2. U slučaju podnošenja žalbe od građana pri Odeljenju Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije, kako je utvrđeno u stavu 1 ovog člana, nadležan za rešavanje ovog pitanja biće Saobraćajni Inspektor ovog Odeljenja.
3. Sve druge žalbe koje nisu deo ovlašćenja Odeljena Javnih Usluga, Sredine i Inspekcije, po članu 17 ovog pravilnika, stranke treba da se obrate LJP "Dardana" AD.

## **KAZNENE ODREDBE**

### **Član 19**

1. Za prekršaj predviđeno članom 15, stav 1 i 5, kažnjavaju se novčanom kaznom od 30€;
2. Za prekršaj predviđeno članom 15, stav 2, 3 i 7, kažnjavaju se novčanom kaznom od 100€;
3. Za prekršaj predviđeno članom 15, stav 4 i 6, kažnjavaju se novčanom kaznom od 20€;
4. Ako pravno lice posluje bez dozvole za obavljanje dotične delatnosti, kažnjava se kaznom od 1000-3000€;
5. Javni ili privatni operater postupa suprotno odredaba ovog pravilnika kažnjava se kaznom od 200€;
6. Javnom ili privatnom operateru, zabranjeno je da vrši usluge popravke ili druge aktivnosti koje utiču na normalno funkcionisanje parkiranja, kažnjava se kaznom od 800 -1 000 €.
7. Za svaki prekršaj javnog ili privatnog operatera koji je suprotno odredaba ovog Pravilnika, kažnjava se kaznom od 100-500€, osim tačaka od 1- 6.
8. Ako javni ili privatni operater ponavlja goreopisane prekršaje do tri i više puta, oduzima mu se dozvola.

## **ZAVRŠNE ODREDBE**

### **Član 20**

Ovaj pravilnik stupa na snagu 15 nakon registracije za Protokol kod Kancelarije Ministarstva Administracije Lokalne Samouprave, kao i objavljivanja na službenim jezicima na sajtu Opštine.

Kamenica,

Datum:xxxxxxxxx

**Predsedavajući Skupštine**

---

**Liridon Kastrati**